

POLICY REPORT



Përmbajtja

- ... Lista e shkurtesave
- ... Parathënie
- ... Pse është e rëndësishme mbikëqyrja financiare e shërbimeve të inteligjencës?
- ... Mbikëqyrja financiare e shërbimeve të inteligjencës në Republikën e Maqedonisë
- ... Rast studimor 1 - Mbikëqyrja financiare e shërbimeve të inteligjencës në Republikën e Sllovenisë
- ... Rast studimor 2 - Mbikëqyrja financiare e shërbimeve të inteligjencës në Republikën e Kroacisë
- ... Përvojat pozitive e vendeve të tjera të rajonit
- ... Konkluzioni
- ... Rekomandime
- ... Bibliografia

Analizë krahasuese e praktikave rajonale për mbikëqyrjen parlamentare financiare të shërbimeve të inteligjencës



Analizë krahasuese e praktikave rajonale për mbikëqyrjen parlamentare financiare të shërbimeve të inteligjencës

Magdalena Lembovska

Ky raport është përgatitur në kuadër të "Projektit Kornizë – Nxitja e Mbikëqyrjes Parlamentare të Sektorit të Sigurisë në Ballkanin Perëndimor", e implementuar nga Qendra e Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura, DCAF (www.dcaf.ch) me financim nga Ministria e Punëve të Jashtme të Norvegjisë. Autor i raportit është hulumtuese në Think Tankun Analytica (www.analyticamk.org), Organizatë Partnere për Zbatim të projektit në Republikën e Maqedonisë.

Pikëpamjet dhe mendimet e shprehura në këtë raport i përkasin autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht ato të Qendrës së Gjenevës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura.

Shkup 2013

**Analizë krahasuese e praktikave rajonale për mbikëqyrjen parlamentare
financiare të shërbimeve të inteligjencës**

Lista e shkurtesave

OShC - Organizata e Shoqërisë Civile

DSK - Drejtoria për Siguri dhe Kundërzbulim

AI- Agjencia e Inteligjencës

MPB - Ministria e Punëve të Brendshme

MM - Ministria e Mbrojtjes

Deputet – Anëtar (Deputet) i Parlamentit

KBFP - Kontrolli i brendshëm financiar publik

EShR- Enti Shtetëror për Revizion

ASIS – Agjencia Sllovene e Inteligjencës dhe Sigurisë

AKIS - Agjencia Kroate e Inteligjencës dhe Sigurisë

ZKSK - Zyra e Këshillit për Siguri Kombëtare

Parathënie

Në vendet demokratike parlamentet luajnë rol thelbësor në ndarjen e burimeve që rrjedhin nga buxheti shtetëror. Si organ përfaqësues i qytetarëve, parlamenti diskuton, aprovon, bënë ndryshime, propozon shtesa dhe miraton buxhetet e çdo institucioni shtetëror, duke përfshire edhe atyre të cilat si aktivitete primar kanë të zbulimin dhe kundërzbulimin. Për më tepër, legjislacioni është i fuqizuar për të mbikëqyrë dhe kontrolluar ekzekutimin e buxheteve të miratuara, në atë mënyre duke përkrahë llogaridhënien.

Qëllimi i këtij studimi është që ti identifikojë praktikat më të mira të mbikëqyrjes parlamentare të shërbimeve të inteligjencës nga rajoni, veçanërisht në procesin e sigurimit të ligjshmërisë dhe legjitimitetit të operimeve të tyre financiare. Në mënyre që ta thjeshtësojmë më tutje këtë shkrim dhe duke pasur parasysh që strukturat e ndryshme organizative nëpër shtetet e ndryshme, termi “shërbime të inteligjencës” do të përdoret në mënyre që i referohet edhe shërbimeve të zbulimit edhe të kundërzbulimit, pavarësisht statuseve të tyre respektive si organe shtetërore të pavarura apo agjenci brenda ministrive përkatëse.

Ky dokument do të jep një shpjegim mbi mekanizmat në dispozicion në shërbim të Parlamentit të Maqedonisë për mbarëvajtjen e mbikëqyrjes parlamentare të shërbimeve të inteligjencës, posaçërisht mbi ato brenda juridiksionit të komisioneve parlamentare të specializuara për këtë. Më pastaj do të analizojë raste nga shtetet e tjera të rajonit duke kërkuar praktika dhe zgjidhje të ligjshme të cilat ata kanë përvetësuar për përkrahjen e llogaridhënies financiare të shërbimeve të tyre të inteligjencës. Si republika Ish-Jugosllave, gjatë dy dekadave të kaluara këto shtete u përballën me sfida nga tranzicioni dhe të ndërtimit të institucioneve demokratike, transparente dhe të përgjegjshme. Megjithatë, jo të gjitha përparuan me të njëjtin ritëm. Praktikrat më të mira i kemi shpjeguar në dy raste studimore – të Sllovenisë dhe Kroacisë, që të dyja shtete anëtare të Bashkimit Evropian. Për më tepër, sistemet e tyre mbikëqyrëse ndryshojnë në shumë nivele, duke pas parasysh se kanë qenë të zhvilluara në bazë të nevojave dhe proceseve specifike të shteteve të tyre. Këto duhen të shërbejnë si shembuj për kuptim më të mirë të rolit të parlamentit në sigurimin e llogaridhënies së shërbimeve të inteligjencës në implementimin e programeve dhe projekteve të financuara me para shtetërore. Ashtu që, pjesa e rasteve studimore mundëson një pasqyrë të shkurtër të shërbimeve formale të inteligjencës dhe të organeve të autorizuara për mbikëqyrjen e tyre. Fokusi është vënë mbi rolin e parlamentit (qoftë ai i drejtpërdrejt apo përmes komisioneve parlamentare) nëpër katër fazat e ciklit buxhetor: planifikimit, miratimit, implementimit dhe revizionit (auditimit).

Ky dokument gjithashtu dallon praktikat më të mira nga shtete tjera të rajonit siç janë Mali i Zi dhe Kosova. Më në fund praktikat më të mira dhe mësimet e nxjerra janë të prezantuara në formë praktike si zgjidhje të aplikueshme.

Të dhënat e përfshira në këtë dokument janë të mbledhura nga burime të hapura, duke përfshirë akte ligjore, raporte prej organizatave kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe artikuj të medias në mes të tjerash. Për qasjen në dy rastet studimore, janë bërë dy vizita në terren, një në Slloveni dhe një në Kroaci, ku intervista kualitative janë realizuar me aktor relevant të vendit.

Pse është e rëndësishme mbikëqyrja financiare e shërbimeve të inteligjencës?

Ka disa arsye pse është e rëndësishme të ekzistojë një mbikëqyrje parlamentare demokratike e burimeve financiare të shërbimeve të inteligjencës. Si e para dhe më e shpeshta, parimet demokratike kërkojnë kontroll dhe llogaridhënie në përdorimin e parave publike. Si e dyte, rreziqet që dalin nga natyra konfidenciale e punës së shërbimeve të inteligjencës mbështet argumentin për të pasur një organ të jashtëm të specializuar që do të kishte mundësi në qasjen në të dhënat konfidenciale. Pak a shumë, ekzaminimi i performancës financiare nënkupton edhe një pasqyrë të performancës të shërbimeve, e cila është gjithashtu një funksion i mbikëqyrjes së pavarur.¹

Natyrë e shërbimeve të inteligjencës, e cila imponon në konfidencialitet të rreptë në punën e saj, duke përfshirë edhe ndarjen e burimeve financiare, kufizon informatat të cilat mund të merren nga publiku i gjerë dhe për këtë po ashtu kufizon edhe numrin e njerëzve të cilët kanë mundësi të vënë në pyetje shpenzimin e parave publike. Kjo krijon një numër të madh të rreziqeve financiare, duke përfshirë edhe keqpërdorimin e financave që rrjedhin nga buxheti shtetëror. Për dallim nga institucionet e tjera shtetërore, këtu hasim në mbikëqyrje të kufizuara për mediet dhe qytetarët, dhe ligjet mbi prokurimin publik nuk aplikohen mbi pjesë të rëndësishme të prokurimit tek shërbimet e inteligjencës. Dhe si e tillë, lind nevoja për institucione të jashtme për mbikëqyrje, siç janë parlamenti dhe institucionet supreme të auditimit, të cilat kanë qasje në informatat e klasifikuara dhe kanë mundësinë të verifikojnë që fondet publike nuk keqpërdoren.

Të dhënat financiare gjithashtu shërbejnë si tregues të sjelljes dhe performancës të shërbimeve të inteligjencës.² Si shtese për zbulimin e keqpërdorimeve të fondeve, mbikëqyrja financiare e shërbimeve të inteligjencës mund të jetë gjithashtu një tregues i aktiviteteve jolegale, siç janë: financimi sekret i partive politike, fonde për qendra jolegale sekrete të paraburgimit, shuma të

¹ Më tepër mbi rëndësinë e mbikëqyrjes financiare të shërbimeve të inteligjencës dhe aspekteve tjera të mbikëqyrjes parlamentare mund të gjenden në: Hans Born dhe Aiden Wills (redaktorë) *Mbikëqyrja e Shërbimeve të Inteligjencës (Overseeing Intelligence Services – A Toolkit)*, DCAF Gjenevë, 2012

² Po aty.

jashtëzakonshme të parave të shpenzuara në aktivitete ose departamente pa dhënien e shpjegimeve të arsyeshme. Për më tepër, shpenzimi i rritur në aspekte specifike të punës së shërbimeve të inteligjencës mund të sugjerojë për nevojë për mbikëqyrje të rritur të disa aktiviteteve.

Qeverisja e mire dhe parimet demokratike cekin se roli kyç në miratimin e burimeve financiare që i ndahen departamenteve të qeverisë duhet ti përket Parlamentit, si institucion përfaqësues i interesave dhe vullnetit të qytetarëve. Fondet e shpërndara nga legjislacioni tek qeveria duhen të jenë subjekt i mbikëqyrjes dhe kontrollit në mënyrë që ti mban institucionet të përgjegjshme dhe të siguron që paratë shpenzohen në mënyrë të ligjshme dhe legjitime, në pajtim me buxhetin e dakorduar. Edhe pse ndonjëherë nënvlerësohen, organet e pavarura siç janë Institucionet Supreme të Auditimit, të cilat i raportojnë parlamentit, mund gjithashtu të luajnë rol të rëndësishëm në mbikëqyrjen financiare të shërbimeve të inteligjencës.

Mbikëqyrja financiare e shërbimeve të inteligjencës në Republikën e Maqedonisë

Kjo pjesë adreson aspektet e ndryshme financiare të punës së shërbimeve të inteligjencës në Maqedoni, si dhe ti kornizës ligjore. Informacione tërësore janë të mundësuar për aktorët përgjegjës për mbikëqyrjen e shpenzimeve të shërbimeve të inteligjencës, posaçërisht për rolin e Parlamentit. Gjithashtu dallon mekanizmat e kontrollit të brendshëm financiar publik (KBFP).

Korniza ligjore dhe buxhetet

Korniza ligjore ekzistuese që rregullon punën e shërbimeve të inteligjencës nuk përmban asnjë dispozitë specifike që i referohet mbikëqyrjes financiare. Mirëpo, Ligji mbi Agjencinë të Inteligjencës³ dhe Ligji i Punëve të Brendshme⁴, që rregullon punën e Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim (DSK) parasheh mbikëqyrje nga komision i autorizuar parlamentar, në këtë rast të Komisionit për Mbikëqyrjen e Punës së Drejtorisë për Siguri dhe Kundërzbulim dhe Agjencisë për Zbulim (tutje vetëm, komisioni për mbikëqyrjen e shërbimeve të inteligjencës). Sipas nenit 11 të Ligjit mbi Agjencinë e Inteligjencës, “drejtori përgjigjet për dhënien e një pasqyre dhe mundësimin e të gjitha informatave dhe të dhënave nga sfera e punës së komisionit”. E njëjta është paraparë në nenin 42 paragrafi 1 të Ligjit të Punëve të Brendshme ku thuhet se “Në kërkesë të Komisionit parlamentar, Drejtoria do të mundësojë pasqyrë të punës dhe do ti mundësojë raportimet e nevojshme, informatat dhe të dhënat tek Komisioni, të cilat janë të rëndësishme për punën e saj”. Edhe pse dispozite strikte mbi mbikëqyrjen financiare parlamentare nuk ekziston, vërehet se të dhënat për performancat financiare nuk përjashtohen nga dokumentacionet në të cilat komisioni ka qasje. Shërbimet e inteligjencës janë të obliguara të japin raport vjetor tek komisioni mbikëqyrës i shërbimeve të inteligjencës, i cili raport do të ishte jo i plotë pa informatat rreth aspekteve financiare të punës së tyre.

Puna e komisioneve përgjegjëse për mbikëqyrjen e shërbimeve të inteligjencës nuk është plotësisht e rregulluar përmes legjislacionit primar. Rregullime relevante për mbikëqyrjen mund të gjenden brenda disa ligjeve (Ligji mbi Agjencinë e Inteligjencës, Ligji mbi Punët e Brendshme, Ligji mbi Përgjimin e Komunikimit), mirëpo që të gjitha japin pak informata rreth autoriteteve të komisionit dhe mekanizmave specifike në dispozicion të tyre në zbatimin e mbikëqyrjes. Kjo është subjekt i rregullimit të brendshëm nëpërmjet Procedurave dhe Rregullave të Punës së tyre.

³ Ligji mbi Agjencinë e Inteligjencës, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Nr.92/2009

⁴ Ligji për Punë të Brendshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Nr.92/2009

Të dhënat për shumën totale të fondeve të ndara për shërbimet e inteligjencës të Maqedonisë janë publikisht të qasshme, mirëpo informacione të detajizuara mbi shpenzimet e tyre janë të kufizuara. Vështirësi të shumta ndodhin kur dikush mundohet të kalkulojë buxhetin e DSK-së dhe Drejtorisë së Inteligjencës Ushtarake, pasi që këto agjenci janë të vendosura brenda MPB dhe MM respektivisht dhe të dyja pranojnë pjesë nga buxheti tërësor i paraparë për ministritë e tyre amë. Është interesante të cekim se ekziston një disproporcion në mes buxheteve të dy agjencive për inteligjencë civile – fondet e ndara për AI janë modeste në krahasim më ato të parapara për DSK.⁵

Roli i Parlamentit

Shërbimet e inteligjencës janë subjekt i mbikëqyrjes dhe kontrollit të brendshëm dhe po ashtu të jashtëm të financave të tyre. Derisa si organe të jashtme me autorizim mbikëqyrës janë Parlamenti dhe EShR, funksioni i KBFP-së, si mekanizëm i brendshëm i vënë për të garantuar përdorim të drejtë të burimeve financiare nuk duhet të nënvlerësohet.

Parlamenti, si organ që përfaqëson vullnetin e qytetarëve, ka disa mekanizma në dispozicion përmes të cilave mund ta ndikon llogaridhënien financiare të shërbimeve të inteligjencës dhe të mbikëqyrës shpenzimin e fondeve të tyre. Mekanizma më e rëndësishme për mbikëqyrje janë komisionet – komisioni që mbikëqyr shërbimet e inteligjencës, si dhe Komisioni për Mbikëqyrjen e Zbatimit të Masave për Përcjelljen e Komunikimeve nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Mbrojtjes (tutje vetëm, komisioni për mbikëqyrjen e përcjelljeve të komunikimit)

Sikur në shtetet demokratike të zakonshme, Parlamenti ka “fuqinë për të ndjek”, në kuptimin se ka fjalën përfundimtare kur bie fjala te ndarja e parave, që është të themi, miratimi i buxhetit. Megjithatë, komisioni i vetëm që diskuton projekt-buxhetin nga aspekti i sigurisë është Komisioni për Mbrojtje dhe Siguri. Komisioni për mbikëqyrje të shërbimeve të inteligjencës dhe komisioni mbikëqyrës i përcjelljes të komunikimit nuk kanë drejtë fjale në këtë proces. Për këto dy komisione, mundësia për të propozuar amendamente shtesë në buxhetin shtetëror mbetet. Komisioni i Financave dhe Buxhetit luan rol të posaçëm në diskutimet e projekt-buxhetit për të gjitha institucionet të financuara nga buxheti shtetëror.

Duke pas në mendje aspektet specifike të punës së shërbimeve të inteligjencës dhe konfidencialitetit të dhënave të lidhura rreth tyre, prioritet duhet dhënë takimeve të komisioneve në vend të sesioneve plenare kur diskutojmë për financat e tyre. Në praktikë, aspektet financiare diskutohen vetëm nga komisionet kur raportet nga shërbimet e inteligjencës janë në agjendë.

⁵ Informata mbi buxhetet e ndara mund të gjenden në uebfaqen e Ministrisë së Financave:
<http://finance.gov.mk/view/budget2013>

Analizë krahasuese e praktikave rajonale për mbikëqyrjen parlamentare financiare të shërbimeve të inteligjencës

Kapitulli i Pestë i Ligjit mbi Parlamentin⁶, i quajtur “Mbikëqyrja parlamentare”, parasheh dëgjime mbikëqyrëse të mbahen nga organet relevante punuese të Parlamentit në mënyrë që të sigurohen informata dhe mendime të ekspertëve të lidhura rreth fushave të saja të kompetencës.

Trupi parlamentar mund të fton përfaqësues të autorizuar të Qeverisë dhe organeve tjera shtetërore dhe të kërkon informata dhe qartësim nga subjektet respektive në seancat dëgjimore mbikëqyrëse.⁷ Përfaqësuesit e autorizuar janë të obliguar të jenë prezent në këto takime.⁸ Person të tjerë poashtu mund të ftohen dhe marrin pjesë në diskutimet të lidhura me mbikëqyrjen, nëse mund të ofrojnë informata relevante rreth temës. Iniciativa për dëgjim mbikëqyrës mund të iniciohet nga cili do anëtar i komisionit përkatës dhe vendimi merret nga shumica e votave të anëtarëve prezent. Në raste kur 15 deputet dërgojnë kërkesë përmes Spikerit të Parlamentit deri te udhëheqësi i komisionit, udhëheqësi i komisionit ka për obligim të thirrur urgjentisht dëgjim.⁹

Çdo e enjte e fundit e muajit është e rezervuar për pyetje parlamentare. Megjithatë, ky mekanizëm ka aplikim të kufizuar kur bëhet fjalë për punën financiare të shërbimeve të inteligjencës, për faktin që kërkohen informata të klasifikuara. Aq më pak, poqëse ndonjë deputet ka leje të sigurisë, ai ose ajo mund të merr përgjigje në formë të shkruar, e cila poashtu do të klasifikohet sipas nivelit të nevojshëm. Anëtar të dyja komisioneve përgjegjëse për mbikëqyrje të shërbimeve të inteligjencës kanë leje për informata konfidenciale të sigurisë. Si të tillë, në raste kur përfaqësuesit e institucioneve nuk janë prezent në sesionet e komisionit apo komisionet e tyre nuk janë mbledhur për ndonjë arsye, këtu mbetet mundësia e mbikëqyrjes të bëhet përmes pyetjeve parlamentare.

Një tjetër mekanizëm që Parlamenti ka janë komisionet ad’hoc për çështje specifike të investigimit, të mundshme për të gjitha subjektet dhe të gjitha çështjet të interesit publik.

Mocion për formimin e një komisioni të tillë duhet të vijë së paku prej njëzet deputetëve. Megjithatë, për aftësinë e thirrjes së dëgjimeve mbikëqyrëse, ad’hoc komisionet ende mbeten për tu njohur si mjete të suksesshme për mbajtjen e institucioneve shtetërore të përgjegjshme.

Enti Shtetëror për Revizion (EShR)

Institucioni më i rëndësishëm kur bëhet fjalë për sigurimin e llogaridhënies financiare të shërbimeve të inteligjencës është EShR. Ky institucion i pavarur shtetëror përbëhet nga

⁶ Ligji mbi Parlamentin e Republikës së Maqedonisë, *Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë Nr. 104/2009*

⁷ *Po aty*, neni 20, paragrafi 2

⁸ *Po aty*, paragrafi 3

⁹ *Po aty*, neni 21.

profesionistë të specializuar në zbulimin e parregullsive financiare dhe përfitimeve nga qasja në informatat e klasifikuara.

Marrëdhëniet ndërmjet Parlamentit dhe EShR-së janë të rregulluara me Ligjin për Revizion Shtetëror.¹⁰ Kryetari dhe nënkryetari i EShR-së zgjidhen nga Parlamenti për një periudhë prej 9 vjetëve. Programi vjetor i EShR-së dorëzohet në Parlament, vetëm për qëllim të informimit.¹¹ EShR gjithashtu paraqet raportet individuale për auditimet e kryera dhe raportin vjetor për punën e saj, por vetëm raporti vjetor i nënshtrohet debatit në Parlament.

EShR nuk kryen auditime të secilit institucion publik në baza vjetore, me përjashtim të buxhetit të shtetit. Auditimet bëhen sipas programit vjetor të përgatitur nga EShR vetë. EShR bëri auditimin e jashtëm të AI-së në vitin 2007 për pasqyrat financiare të vitit 2006. EShR deklaroi se "pasqyrat financiare mbi operacionet e rregullta të Agjencisë për vitin 2006, me vërtetësi dhe në mënyrë të drejtë paraqesin pozicionin financiar dhe rezultatet e çdo aktiviteti financiar, duke pasur parasysh kornizën e tanishme ligjore. Sipas mendimit tonë, AI në mënyrë të ligjshme dhe të drejtë i ka përdorur fondet në transaksionet financiare, të cilat përfaqësojnë shpenzimet shtetërore për vitin 2006."¹²

Disa parregullsi janë gjetur, të tilla si mosekzistimi i akteve të brendshme të rregullimit të punës së njësive (për llogari të operacioneve të rregullta), si dhe fondet e shpenzuara pa qëllime të arsyeshme dhe pa dokumentacione të besueshme.¹³ Në Ministrinë e Brendshme, një kontroll u zhvillua në vitin 2008, gjatë së cilës disa parregullsi janë zbuluar, mirëpo nuk ka asnjë informacion në dispozicion posaçërisht për DSK si pjesë përbërëse e MPB-së. Megjithatë, raportet individuale në auditimin e kryer në shërbimet e inteligjencës nuk janë diskutuar nga komisionet përkatëse mbikëqyrëse për punën e tyre.

Qasja në dokumentacionin e shërbimeve të inteligjencës është e kufizuar për institucionet e tjera dhe publikun e gjerë në përgjithësi, për rrjedhojë, mundësia e zbulimit të ndonjë lloji të keqpërdorimit është gjithashtu e kufizuar. Si e tillë, është e rëndësishme që EShR ti kushton vëmendje raporteve financiare të shërbimeve të inteligjencës dhe auditimit, dhe të fillon të kryen auditime të rregullta në intervale kohore më të shkurtra. Komunikimi i forcuar në mes të Parlamentit dhe EShR-së do të kontribuojë gjithashtu në rritjen e përgjegjshmërisë financiare.

¹⁰ Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, Nr. 66/10

¹¹ Ligji për Revizion Shtetëror, *Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë*, neni 23

¹² Raporti final i Auditorit Shtetëror të autorizuar Nr. 1003-656/6 ku mund të gjendet në:

<http://www.dzr.mk/Uploads/2006%20-%20Agen%20za%20razuznavanje-Budzet.pdf>

¹³ Raporti vjetor I Entit Shtetëror për Revizion për 2007:

<http://www.dzr.mk/Uploads/MIJALCO%20-%20Godisen%20izvestaj%20za%20WEB%20-%20FINALE.pdf>

Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik (KBFP)

KBFP¹⁴ është një mjet thelbësor për të siguruar që paratë publike shpenzohen në mënyrën sa më të përshtatshme dhe efikase. Në bazë të Ligjit për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik, të gjithë përdoruesit buxhetore kanë një detyrim për të krijuar një njësi për çështjet financiare dhe një njësi të auditimit të brendshëm, dhe për të caktuar një person përgjegjës për informim për parregullsi. Hulumtimi i Analitik-ës ka treguar se deri më tani të gjitha përpjekjet kanë qenë të drejtuara drejt miratimit dhe përmirësimit të kornizës ligjore (të përbërë nga Ligji për Kontrollin e Brendshëm Financiar dhe një numër të akteve nënligjore), por përpjekje shtesë janë të nevojshme për ti vënë më mirë dispozitat ligjore në praktikë.

Megjithatë, AI, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Mbrojtjes (si institucione të cilat merren me zbulimin dhe kundërzbulimin) kanë ndërmarrë të gjitha aktivitetet e nevojshme për të krijuar njësi organizative për çështjet financiare dhe të auditimit të brendshëm dhe kanë caktuar personin përgjegjës për raportimin e parregullsive, që nuk është rasti për të gjitha institucionet shtetërore në nivel qendror. Edhe pse karakteristikat e vendosura nga ligji janë vendosur në këto institucione, KBFP nuk zbatohet plotësisht në të gjitha shërbimet e inteligjencës. Për shembull, AI dhe MPB nuk kanë burime njerëzore të mjaftueshme për të kryer auditime të brendshme, të cilat mund të pengojnë frekuencën dhe cilësinë e auditimeve të kryera.¹⁵

Roli i medieve dhe shoqërisë civile

Media dhe shoqëria civile duhet të nxisin debate publike, duke ngritur pyetje mbi aspekte të ndryshme të punës së shërbimeve të inteligjencës. Mediet zakonisht përmendin shërbimet e inteligjencës, kur ndonjë skandal del në sipërfaqe apo kur komisioni mbikëqyrës i shërbimeve të inteligjencës diskuton mbi raportet e paraqitura nga shërbimet. Gazetarët u interesuan

¹⁴ Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik është term i përdorur nga Komisioni Evropian në Kapitullin 32 Kontrollin Financiar. KBFP përfaqëson një menaxhment plotësisht të konsoliduar, sistem monitorues, kontrollues dhe të sistem auditimi për fondet kombëtare publike dhe fondet të BE-së të përcaktuara nga Qeveria. Sistemi i KBFP është i përbërë nga:

- (1) Menaxhmenti financiar dhe sistemi i Kontrollit;
- (2) Auditimi i Brendshëm; dhe
- (3) Harmonizimi i kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm.

¹⁵ Më shumë rreth sistemit të KBFP në sektorin e sigurisë mund të gjenden në: Andreja Bogdanovski dhe Magdalena Lembovska - *Drejt brezit të dytë (2) të sektorit të sigurisë në reformat në Maqedoni*, Shkup 2012, në dispozicion në: <http://analyticamk.org/images/stories/books/pub-ssr-web.pdf>

veçanërisht në buxhetin e DSK-së në vitin 2008, kur rebalancim i buxhetit në korrik të njëjtin vit tregoi se buxheti i këtij shërbimi është shumëzuar me tridhjetë e dy, pa ndonjë shpjegim.¹⁶

Shoqëria civile në Maqedoni është kryesisht e brengosur me mbikëqyrjen e përgjithshme demokratike të shërbimeve të inteligjencës dhe shkeljeve të drejtave dhe lirive të njeriut. Aspektet financiare të punës së kësaj pjese të aparatit shtetëror nuk janë aq shpesh në qendër të vëmendjes të OShC-ve.

¹⁶ Globus weekly *Policia e fshehtë do të shpenzojë 25 milion euro* (The secret service will secretly spend 25 million Euros) në dispozicion: <http://www.globusmagazin.com.mk/?ItemID=CC73D07EE4E7354BA099566AFDB5EF77>

Rast studimor 1 - Mbikëqyrja financiare e shërbimeve të inteligjencës në Republikën e Sllovenisë

Shërbimet Inteligjente

Përderisa Maqedonia ka dy agjenci të ndryshme civile që merren me shërbime të inteligjencës dhe kundërzbulimin veç e veç, aktivitetet e zbulimit dhe kundërzbulimit në Slloveni janë të bashkuara në një shërbim civil - Agjencinë Sllovene të Inteligjencës dhe Sigurisë (ASIS). ASIS është institucion i pavarur qeveritar, dhe kryen detyrat e saj në bazë të prioriteteve të përcaktuara nga Qeveria, të cilat dalin nga Programi i Sigurisë Kombëtare i miratuar nga Asambleja Kombëtare. Ligji që rregullon punën e ASIS parashikon miratimin e një ligji për mbikëqyrjen parlamentare. Në të njëjtën kohë ajo gjithashtu thekson obligimet e ASIS ndaj komisionit parlamentar, për shembull: për të paraqitur një program dhe raportet, për të lejuar inspektimin e dokumentacionit dhe pajisjeve teknike dhe përdorimit të objekteve, etj.¹⁷

Inteligjenca ushtarake, në ndërkohë është e vendosur në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes, si një shërbim i veçuar i inteligjencës dhe sigurisë. Përveç ASIS dhe të shërbimit të ushtarak të inteligjencës, autoritete të veçanta (të tilla si vëzhgimi sekret) janë të caktuara për policinë, e cila është gjithashtu subjekt i mbikëqyrjes parlamentare. Në fakt, policia i përdorë autoritetet e tilla për inteligjencën e krimit në kuadër të departamentit të hetimit kriminal.

Mbikëqyrja dhe roli i Parlamentit

Komisioni për Mbikëqyrjen e Shërbimeve të Inteligjencës dhe Sigurisë, një organ në kuadër të Asamblesë Kombëtare luan një rol kryesor në mbikëqyrjen parlamentare. Ajo që e dallon këtë komision nga homologët e tij në rajon është ekzistenca e një ligji të specializuar për mbikëqyrjen parlamentare,¹⁸ i krijuar në vitin 2003, duke i paraqitur funksionet e saj në mënyrë të detajuar. Për dallim nga rasti i Maqedonisë, rregullorja e punës së këtij Komisioni nuk miratohet nga Komisioni vetë, por nga plenumi.

Komisioni kryen mbikëqyrjen e shërbimeve inteligjente dhe të sigurisë, duke përfshirë: ASIS, shërbimin e inteligjencës në kuadër të MM-së dhe shërbimin e sigurimit në kuadër të MPB-së. Përveç kryerjes së mbikëqyrjes dhe përputhshmërisë së aktiviteteve të tyre me Kushtetutën, ligjet dhe politikën e sigurisë kombëtare, Ligji për Mbikëqyrjen Parlamentare në mënyrë eksplicite

¹⁷ Ligji mbi Agjencinë Sllovene të Inteligjencës dhe Sigurisë – version i konsoliduar (ZSOVA-UPV2) R.S. *Gazeta Zyrtare Nr.81/06* neni 49

¹⁸ Ligji mbi Kontrollin parlamentar i Shërbimeve të Inteligjencës dhe Sigurisë *Gazeta Zyrtare e RS, Nr 26/03 - ZPNOVS*

thotë se ky komision ka autoritetin për të diskutuar raportet e punës dhe operacioneve financiare të shërbimeve të inteligjencës, si dhe për të diskutuar projekt-buxhetin vjetor dhe projekt-akte të tjera që lidhen me financimin e shërbimeve të inteligjencës.¹⁹

Një herë në vit, Komisioni ia paraqet raportin vjetor për punën e tij dhe gjetjet e përgjithshme të aktiviteteve të mbikëqyrjes Kuvendit Kombëtar. Ajo gjithashtu propozon miratimin e pozicioneve dhe vendimeve në lidhje me kontrollin.²⁰

Së bashku me këtë komision, roli i Komisionit për Kontrollin e Financave Publike gjithashtu është i rëndësishëm. Ajo kontrollon zbatimin e buxhetit të shtetit, shqyrton raportet vjetore financiare të buxhetit dhe diskuton raportet financiare të Gjykatës së Auditimit (institucioni suprem i auditimit, që korrespondon me ISA). Komisioni i paraqet Asamblesë Kombëtare raportet në lidhje me kontrollin e kryer dhe rekomandon veprime të nevojshme. Kryetarët e dy komisioneve gjithmonë vijnë nga radhët e opozitës, e cila forcon pozitën e tyre dhe mundëson një nivel më të lartë të pavarësisë.

Në tekstin e mëposhtëm fokusi do të vihet në Komisionin për Mbikëqyrjen e Shërbimeve të Inteligjencës dhe Sigurisë (tutje vetëm, Komisioni mbikëqyrës ose Komisioni) dhe rolin e saj në secilën fazë të ciklit buxhetor: planifikimit, miratimit, zbatimit dhe auditimit.

Formulimi i buxhetit

Buxheti vjetor përgatitet nga Qeveria dhe i dorëzohet Parlamentit.²¹ Komisioni mbikëqyrës shqyrton projekt-buxhetin e shërbimeve të inteligjencës, si dhe projekt rregulloret e tjera të cilat kanë të bëjnë me financimin e shërbimeve të inteligjencës.²² Raportet dhe projekt buxhetet janë të strukturuar në të njëjtën mënyrë si buxheti qeveritar, me shtesë të ashtuquajturave "fonde speciale", të cilat krijohen me ligj për përdorim vetëm nga shërbimet me kompetenca të veçanta. Rregullat njëjtat të kontabilitetit aplikohen për fondet e veçanta si për ato të shpenzimeve publike, por janë të mbajtura sekret. Për më tepër, shpenzimet e fondet të veçanta nuk janë subjekt i tatimit. Të gjitha dokumentet, të cilat janë të detajuara në një llogari të veçantë (konto), klasifikohen.²³ Çdo janar, Qeveria paraqet një program të veçantë vjetor për secilin shërbim.

Buxheti i ASIS, është dokument publikisht i qasshëm, përmban informacione mbi fonde të caktuara të sigurisë kombëtare, të mbrojtjes dhe të punëve të jashtme, punëve të brendshme dhe sigurisë kombëtare. Ai përmban të dhëna të detajuara për shuma specifike në planin e shpenzimeve për mbledhjen e informacioneve me anë të mjeteve teknike (SIGINT) ose duke përdorur sistem modern të informacionit-telekomunikacionit, si dhe përqindjen që do të ndahen

¹⁹ *Po aty*, neni 13.

²⁰ *Po aty*, neni 34.

²¹ Ligji mbi Financat Publike, *Gazeta Zyrtare e R.S. Nr. 79/1999*

²² Ligji mbi Kontrollin Parlamentar të shërbimeve të inteligjencës dhe sigurisë, *Gazeta Zyrtare e RS, Nr 26/03 - ZPNOVS*. neni 13

²³ Intervistë me Andrej Rupnik-ish-drejtori i ASIS

për mbledhjen e informacioneve nga inteligjenca njerëzore (HUMINT) ose informacione të fituara përmes bashkëpunimit ndërkombëtar.

Miratimi i buxhetit

Kur diskutohet për projekt-buxhetin për vitin e ardhshëm, Komisioni mbikëqyrës do ta mbështesë atë, nëse ajo është mjaft i detajuar dhe mund të justifikohet me kriteret e shërbimeve të inteligjencës, duke iu referuar se si dhe në çfarë paratë do të shpenzohen. Komisioni mbikëqyrës mund edhe të propozojë që të ndajë fonde shtesë, për sa kohë që ajo e percepton se ka nevojë për këtë.

Komisioni Mbikëqyrës është filtri i parë para se buxheti të miratohet në të vërtetë. Pastaj, buxhetet e shërbimeve të inteligjencës, si pjesë të buxhetit të shtetit, miratohen në seancë plenare.

Ekzekutimi i Buxhetit

Ligjvënësit kanë qenë të kujdesshëm që të sigurojnë Komisionin mbikëqyrës me mekanizma të shumta për kryerjen e mbikëqyrjes mbi shpenzimin e financave publike nga ana e shërbimeve të inteligjencës – nga diskutimi i raporteve të shërbimit, deri në thirrjen në pyetje të zyrtarëve të shërbimeve të inteligjencës, dhe vizitave të autorizuara në terren nëpër objektet e tyre.

Çdo katër muaj, dhe më shpesh nëse është e nevojshme, shërbimet e inteligjencës dorëzojnë raporte për punën e tyre. Gjatë vitit, Komisioni mund të kërkojë nga Qeveria të paraqesë një raport mbi punën financiare të shërbimeve të inteligjencës dhe sigurisë,²⁴ e cila do të përmbante informata mbi shumën e saktë dhe qëllimin e mjeteve financiare për përfundimin e detyrave të caktuara.

Një herë në vit (në Shkurt) Qeveria dorëzon raport të përgjithshëm mbi punën dhe veprimet financiare të çdo shërbimi të zbulimit për vitin e kaluar.²⁵ Ky raport përmban informacione të detajuara rreth aktiviteteve të rëndësishme për sigurinë kombëtare, si dhe mbi shumën dhe përdorimin e parashikuar të burimeve financiare për kryerjen e detyrave individuale.²⁶

Raportet përmbajnë informacion të përgjithshme për çështjet financiare, që do të thotë shumën e fondeve që janë shpenzuar dhe për të cilat qëllime të përgjithshme (udhëtime, strehim, të blerjeve të veçanta, pagesa për burimet, etj). Megjithatë, ka një dallim në mes të policisë dhe shërbimeve të inteligjencës: Policia raporton vetëm për shpenzimet gjatë kryerjes së masave të posaçme hetimore (të përcaktuara në Ligjin e Procedurës Penale), ndërkohë që shërbimet e inteligjencës informojnë për gjendjen financiare të plotë dhe të gjitha aspektet e shpenzimeve - pagat,

²⁴ Ligji mbi Kontrollin Parlamentar të shërbimeve të inteligjencës dhe sigurisë, *Gazeta Zyrtare e RS, Nr 26/03 - ZPNOVS*, neni 18

²⁵ *Po aty*, neni 16

²⁶ *Po aty*, neni 21

shpenzime të tjera të lidhura me punën, investimet, shpenzimet funksionale, duke përfshirë kostot e shërbimit të fshehtë të inteligjencës dhe të punës së sigurisë.²⁷ Sipas ligjit, Komisioni mbikëqyrës mund të kërkojë të dhëna të hollësishme mbi operacionet financiare me mjete të ndara.²⁸

Me kërkesën e Komisionit Mbikëqyrës, kreu i shërbimit duhet të paraqesë me gojë cilindo nga raportet e dorëzuara në takim të Komisionit, si dhe ti përgjigjet pyetjeve të anëtarëve të komisionit. Të drejtën për të refuzuar të dëshmojë ose të përgjigjet në pyetje të veçanta është e lejuar në raste të veçanta të rregulluara me Ligjin e Procedurës Penale. Kjo do të thotë se një person i ftuar "nuk është i detyruar të inkriminojë vetveten ose të afërtin pranë tij, dhe as të pohojë fajësinë".²⁹ Pas diskutimit, zyrtari i thirrur lë seancën dhe deputetët komentojnë në përgjigjet e tij në mungesë të tij.³⁰ Komisioni mbikëqyrës mund të kërkojë ndonjë nga të punësuarit në shërbim për të marrë pjesë në takimin e Komisionit dhe të jep shpjegime dhe përgjigjet pyetjeve. Por, në të njëjtën kohë, Komisioni Mbikëqyrës duhet të jetë i sigurt që identiteti i tij/saj është i mbajtur sekret. Për dyshimet në lidhje me ndonjë parregullsi, punonjësit mund të informojnë Komisionin në çdo kohë.

Një tjetër mekanizëm i futur në Ligjin për mbikëqyrjen parlamentare është e drejta e vizitave të paralajmëruara dhe të paparalajmëruara në ambientet e shërbimeve informative nga një grup i autorizuar i Komisionit Mbikëqyrës. Komisioni nuk bënë asnjëherë vizitë me përbërjen e tij të plotë, por formon një grup prej të paktën tre anëtarë, ku duhet gjithmonë të ketë të paktën një anëtar nga koalicioni qeverisës dhe një nga opozita. Në këtë mënyrë, ligjvënësit u përpoqën ti shmangin abuzimin dhe zhvlerësimin e këtij mekanizmi, me shumë gjasa do të ndodhte ashtu në qoftë se vetëm anëtarët nga një parti e vetme do ta kryenin vizitën në terren. Në qoftë se të paktën tre anëtarë të Komisionit mbikëqyrës sugjerojnë një vizitë të cili do shërbim, vizita atëherë duhet të kryhet. Një rregull i tillë është një mjet i rëndësishëm që pengon vullnetin e shumicës për të kufizuar fuqinë për të kryer mbikëqyrje. Sipas Mate Dragutin, anëtar i Komisionit për Mbikëqyrjen e Shërbimeve të Inteligjencës dhe Sigurisë, Komisioni viziton disa nga shërbimet, një herë në muaj. Ajo gjithashtu ka autoritetin për të hetuar dokumentet dhe materialet e tjera dhe të dhënat e shërbimit të kontrolluar në lidhje me kompetencat dhe detyrat e saj.³¹ Megjithatë, financat nuk janë pika kryesore me interes për deputetët, në vend të kësaj fokusi kryesor është shpesh mbrojtja e të drejtës së privatësisë dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut.³² Nuk është e qartë çka përcakton fokusin e mbikëqyrjes, duke pasur parasysh faktin se

²⁷ Intervistë me Andrej Rupnik-ish-drejtori i ASIS

²⁸ Ligji mbi Kontrollin Parlamentar të shërbimeve të inteligjencës dhe sigurisë, *Gazeta Zyrtare e RS, Nr 26/03 - ZPNOVS*. neni 21, paragrafi 3

²⁹ Ligji mbi Procedurën Penale, *Gazeta Zyrtare e Republikës së Sllovenisë 8/2006* në dispozicion në: <http://www.policija.si/eng/images/stories/Legislation/pdf/CriminalProcedureAct2007.pdf>

³⁰ Intervistë me Mate Dragutin, anëtar i Komisionit për Mbikëqyrje të shërbimeve të inteligjencës dhe sigurisë

³¹ Ligji mbi Kontrollin Parlamentar të shërbimeve të inteligjencës dhe sigurisë, *Gazeta Zyrtare e RS, Nr 26/03 - ZPNOVS*. neni 25

³² Intervistë me Mate Dragutin

mbikëqyrja e drejtë përfshin shumë aspekte të punës së shërbimeve të inteligjencës, përfshirë edhe performancën financiare.

Dokumentet e lidhura me misionet aktive, ose ato që rrezikojnë zbulimin e identitetit të agentëve brenda shërbimit, përjashtohen nga shqyrtimi i hollësishëm i Komisionit. Ekziston rregulli i saktë i procedurës ku kreu i shërbimit i mohon qasje në disa dokumentacione. Nëse kjo ndodh gjatë ndonjë vizite në terren nga Komisioni Mbikëqyrës, Kreu i shërbimit ka afat prej një orë për ti bërë propozim Qeverisë në mënyrë që qasja të mohohet. Edhe në qoftë se qeveria mbështet kreun e shërbimit në vendimin e tij, Komisioni Mbikëqyrës mund të vendosë ta refuzojë atë vendim dhe të kërkojë dokumentin.³³ Kjo mund të bëhet vetëm me dy të tretat e shumicës në një thirrje të iniciuar nga kryesuesi i komisionit

Auditimi i Buxhetit

Gjykata e Auditimit, një organ i pavarur auditimi, luan një rol kryesor në sigurimin e llogaridhënies financiare të shërbimeve të inteligjencës. Ky institucion ka luajtur rolin kyç në vitin 2007, kur një denoncues nga ASIS informoi Qeverinë për shpërdorim të buxhetit të AI-së. Më pas, ekspertët financiarë nga Gjykata e Auditimit kaluan një vit duke punuar në rastin dhe konfirmuan se burimet financiare nuk janë shpenzuar ligjërisht. Në këtë rast, Komisioni për Mbikëqyrjen e Inteligjencës dhe Sigurisë dështuan ta njohin me kohë rastin e keqpërdorimit.

Auditimi i ASIS kryhet në të njëjtën mënyrë si në çdo institucion tjetër publik, dhe të njëjtat dispozita ligjore zbatohen. Gjykata e Auditimit vendos në mënyrë të pavarur se cilat institucione do të jenë subjekt të auditimit, por gjithashtu pranon edhe propozime për këtë. Propozimi mund të vijë nga Asambleja Kombëtare, Qeveria, ministritë, administratat e komunave, qytetarët, OShC-të dhe mediet. Gjykata e Auditimit është e detyruar të miratojë dhe të zbatojë në të paktën pesë propozime nga Asambleja Kombëtare në programin e saj vjetor (nga të cilat dy duhen të vijnë nga opozita dhe të paktën dy nga trupat punuese). Në këtë mënyrë, Gjykata e Auditimit fiton një ide të qartë në lidhje me fushat e vëmendjes të Parlamentit, por është ende në gjendje të vendosë në mënyrë të pavarur se cilat propozime do ti miratojë.

Raportet nga auditimi i shërbimeve të inteligjencës, të cilat janë të shënuar si të klasifikuara, diskutohen në takimet e Komisionit për Mbikëqyrjen e Shërbimeve të Inteligjencës dhe Sigurisë. Një raport i përgjithshëm, i cili është gjithashtu temë e diskutimit, i dorëzohet Komisionit për Kontrollin e Financave Publike. Ky Komision, në bazë të diskutimeve të saja, mund të propozojë ndonjë raport individual që të përfshihet në rendin e ditës në seancë plenare dhe të propozojë masa të caktuara që duhen të zbatohen. Në një rast, ku janë zbuluar parregullsi nga ana e Gjykatës së Auditimit, është e detyrueshme që raporti të diskutohet në nivelin plenar.

³³ Poslovník Komiseje za nadzor obveščalnih in varnostnih služb (Rregullorja e Punës për Mbikëqyrje mbi Agjencitë e Shërbimeve të Inteligjencës dhe Sigurisë) neni 23 paragrafi 2

Komisioni për Kontrollin e Financave Publike ka bashkëpunim të shpeshtë me Gjykatën e Auditimit. Ajo mund të sugjeroj një kontroll në cilindo institucion për të bëhet çdo dy muaj përderisa ajo mbledh informacione në lidhje me auditimet që janë në progres. Gjatë takimeve të Komisionit, një përfaqësues nga institucioni që është audituar është thirrret për t'iu përgjigjur pyetjeve. Shërbimi ekspert i Komisionit mban një kopje të çdo vendimi të miratuar nga Komisioni dhe zbatimin e tij. Një herë në vit, Komisioni diskuton raportin për zbatimin e vendimeve të miratuara. Subjektet të cilat nuk kanë zbatuar vendimet nga Komisioni mund të thirren përsëri nga Komisioni në mënyrë që ta bëjnë këtë.

Përveç kësaj, Gjykata e Auditimit bashkëpunon shpesh me auditorët e brendshëm të institucioneve, dhe gjithashtu me Komisionin për auditimin e buxhetit, trupin e brendshëm të Ministrisë së Financave. Aktivitetet përfshijnë takime të shpeshta dhe pjesëmarrje në ngjarje të ndryshme, në mesin e të tjerëve. Edhe pse kjo nuk mund të duket të jetë e lidhur me Parlamentin, ajo krijon një ambient të llogaridhënies dhe përgjegjësisë, duke siguruar menaxhim të drejtë të burimeve financiare, duke përfshirë ato që kanë sigurinë kombëtare në mandatin e tyre.

Kapacitetet administrative dhe menaxhuese

Komisioni për Mbikëqyrjen e Shërbimeve të Inteligjencës dhe Sigurisë përbëhet nga nëntë anëtarë,³⁴ duke përfshirë edhe kryetarin e Komisionit dhe nënkryetarin. Shumica e anëtarëve, si dhe kryetari, i përkasin partive opozitare. Të gjithë anëtarët propozohen nga grupet e tyre parlamentare dhe emërohen nga Asambleja Kombëtare me shumicë votash. Asambleja Kombëtare zgjedh kryetarin e Komisionit. Për shkak të natyrës së punës së tyre, nëse ndonjë anëtar mungon, ai ose ajo nuk mund të zëvendësohet. Nëse një parti politike kërkon të ndryshojë disa nga anëtarët e saj ose ndonjë anëtar dëshiron të anulojë pjesëmarrjen e tij ose të saj gjatë mandatit, kjo diskutohet në nivel plenar dhe vendimi miratohet me shumicë votash nga të gjithë anëtarët e Parlamentit. Në këtë mënyrë ligjvënësit janë përpjekur të parandalojnë manipulimet e mundshme nga partitë politike në rast se ata duan të shkarkojnë ose të caktojnë ndonjë person të caktuar në Komision në një periudhë të caktuar.

Anëtarët e Komisionit Mbikëqyrës nuk i nënshtrohen procesit të verifikimit. Pavarësisht nga kjo, pasi ata të emërohen, ata fitojnë qasje të pakufizuar në të gjitha të dhënat brenda fushëveprimit të tyre të punës, pa marrë parasysh çfarë niveli i klasifikimit.

Komisioni Mbikëqyrës ka një objekt të veçantë në Asamblenë Kombëtare për mbledhjet e tij. Dhoma ofron të gjitha kushtet për punë të papenguar me informacione të klasifikuara, dhe telefonat celular nuk janë të lejuara gjatë takimeve. Mjetet transportuese të Asamblesë Kombëtare duhen të jenë në dispozicion të anëtarëve të Komisionit në çdo moment, në qoftë se

³⁴ Sipas nenit 10 të Ligjit për Mbikëqyrje Parlamentare, Komisioni mund të ketë më së shumti nëntë anëtarë

ata vendosin të vizitojnë ndonjë prej agjencive të inteligjencës dhe sigurisë që ata mbikëqyrin.³⁵ Kur Komisioni Mbikëqyrës formohet për herë të parë në mandatin e ri, një vizitë informative i bëhet çdo shërbimi të kontrolluar në mënyrë që të njihen nga afër anëtarët me shërbimet dhe punën e tyre. Anëtarët marrin një koleksion të dokumenteve ku shpjegohen në hollësi rregullat në lidhje me mbikëqyrjen parlamentare së bashku me përshkrime të dispozitave të veçanta ligjore .

Puna e Komisionit asistohet nga një sekretar i cili është ekspert në këtë fushë. Përveç punës së tyre administrative, ai ose ajo gjithashtu luan një rol në vizitat e autorizuara të shërbimeve. Megjithatë, këtij Komision Mbikëqyrës i mungon ekspertizë dhe trajnime shtesë në mbikëqyrje financiare. Në Komisionin e tanishëm (i formuar në vitin 2011), asnjë prej anëtarëve kanë arsimim apo përvojë profesionale në financa.

Komisioni Mbikëqyrës punon prapa dyerve të mbyllura, por me propozim të kryetarit ose zëvendësit të tij, me një votim të dy të tretave të shumicës, të gjitha ose një pjesë e seancës mund të jenë të hapura për publikun. Megjithatë, kjo nuk mund të praktikohet kur raportet e shërbimeve të inteligjencës diskutohen. Komisionit i lejohet gjithashtu që të ftojë ekspertë dhe profesionistë për të marrë pjesë në takimet e caktuara dhe të shprehin pikëpamjet dhe mendimet e tyre.

³⁵ Intervistë me Mate Dragutin

Rast studimor 2 - Mbikëqyrja financiare e shërbimeve të inteligjencës në Republikën e Kroacisë

Shërbimet Inteligjente

Ngjashëm me rastin e Sllovenisë, Republika e Kroacisë ka një agjenci civile të inteligjencës që bashkon zbulimin dhe kundërzbulimin - Agjencia Kroate e Inteligjencës dhe Sigurimit (AKIS). Zbulimi dhe kundërzbulimi ushtarak është në kuadër të Ministrisë së Mbrojtjes, si Shërbimi Ushtarak i Sigurisë dhe Zbulimit. Edhe pse Policia në kuadër të MPB-së ka autorizime të veçanta, duke përfshirë përdorimin e masave të veçanta hetuese, ajo nuk është subjekt i mbikëqyrjes parlamentare.

Për dallim nga Sllovenia, ku mbikëqyrja parlamentare e shërbimeve të inteligjencës është e rregulluar me ligje të veçanta, ligjvënësit kroatë kanë vendosur në një qasje të ndryshme. Të gjitha rregulloret për sistemin e sigurisë dhe inteligjencës janë sistemuar në një ligj, Ligjin për Sistemin e Sigurimit e të Zbulimit në Republikën e Kroacisë. Ky ligj e detajon pozicionin e çdo pjesëmarrësi kyç nga fusha, përfshi këtu rolin e Parlamentit.

Mbikëqyrja dhe roli i Parlamentit

Mbikëqyrja e agjencive të zbulimit është e organizuar në tri nivele: civil, parlamentar dhe atë ekspert.

Mbikëqyrja civile është një praktikë që nuk gjendet në vendet e tjera në rajon dhe kjo është një hap më tej në drejtim të sigurimit të llogaridhënies dhe përgjegjësisë së shërbimeve të zbulimit. Në Kroaci, ky lloj i mbikëqyrjes kryhet nga Këshilli për Mbikëqyrje Civile mbi Agjencitë e Sigurisë dhe të Zbulimit, i përbërë nga gjashtë anëtarë dhe një president i caktuar nga Parlamenti, para të cilit përgjigjet. Këshilli mbikëqyr përputhshmërinë e agjencive të sigurisë dhe zbulimit me dispozitat ligjore ku fokusi është vendosur në zbatimin e masave për mbledhjen e të dhënave të fshehta që mund të kufizojnë të drejtat dhe liritë e garantuara me Kushtetutë. Mbikëqyrja e financave nuk kryhet nga ky organ.

Mbikëqyrja eksperte kryhet nga Zyra e Këshillit për Siguri Kombëtare. Kjo Zyrë kryen punën eksperte dhe administrative të Këshillit për Siguri Kombëtare³⁶ dhe Këshillit për Koordinim të

³⁶ Këshilli i Sigurimit Kombëtar përbëhet nga: kryetari i shtetit, kryeministri, anëtar i qeverisë përgjegjës për sigurinë kombëtare, ministri për punë të jashtme, ministri për drejtësi, këshilltar i presidentit për siguri kombëtare, shefi i Shtabit të përgjithshëm të forcave të armatosura, drejtori i AKIS, drejtori i agjencisë së inteligjencës

Analizë krahasuese e praktikave rajonale për mbikëqyrjen parlamentare financiare të shërbimeve të inteligjencës

Agjencive të Sigurimit dhe Zbulimit. Mbikëqyrja profesionale përbëhet nga monitorimi dhe kontrollimi i ligjshmërisë së punës, efikasitetin dhe dobinë e punës, masat për mbledhjen e fshehtë të të dhënave, dhe kontrollin mbi përdorimin e burimeve financiare.

Mbikëqyrja parlamentare, sipas Ligjit për Sistemin e Sigurisë dhe Zbulimit, mbikëqyrja bëhet direkt nga Parlamenti ose nëpërmjet komisionit parlamentar përgjegjës për sigurinë kombëtare,³⁷ në këtë rast Komisioni për Politikë të Brendshme dhe Siguri Kombëtare. Megjithatë, ky Komision jo vetëm që është i specializuar në mbikëqyrjen, por edhe është Komisioni amë për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me:³⁸

- strukturën dhe autoritetin e administratës shtetërore në fushën e politikës së brendshme;
- shtetësinë dhe statusin personal të qytetarëve;
- sigurinë publike dhe shtetërore, sigurinë e trafikut, mbrojtjen nga zjarret dhe fatkeqësitë natyrore;
- raportet nga Zyra e Kontrollit Qendror, policia financiare dhe hetimet penale të policisë në atë fushë që kanë të bëjnë me parregullsitë në punën financiare të organeve shtetërore,
- pyetje tjera nga politika e brendshme, siguria kombëtare dhe mbrojtja.

Sipas Rregullores së Punës së Parlamentit Kroat Komisioni kryen mbikëqyrjen e agjencive të sigurisë dhe zbulimit, veçanërisht në lidhje me mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të njeriut të garantuara me Kushtetutë. Vlen të theksohet se ky Komision luan rol në emërimin e kreut të AKIS dhe kreut të zbulimit ushtarak. Në fakt, para emërimit të tyre, Komisionit interviston kandidatët dhe ia raporton mendimin e vet Kuvendit. Si organ amë për të gjitha çështjet në lidhje me politikën e brendshme dhe sigurisë kombëtare puna e këtij Komisioni mbulon një spektër të gjerë që mund të konsiderohet një faktor kufizues për kryerjen e duhur të mbikëqyrjes financiare.

Formulimi i buxhetit

Fondet për agjencitë e zbulimit sigurohen nga buxheti vjetor kombëtar i Republikës së Kroacisë. Në bazë të Ligjit për Sistemin e Sigurisë dhe Zbulimit të Kroacisë³⁹ Parlamenti nuk është i përfshirë në këtë fazë të formulimit, por shumica e fondeve që ndahen për shërbimet vendoset nga Këshilli Kombëtar i Sigurimit⁴⁰ (i përbërë nga zyrtarët më të lartë të shtetit dhe krerëve të agjencive të sigurisë dhe zbulimit). Burimet për punën e agjencive të inteligjencës dhe sigurisë

ushtarake- sigurisë, dhe kreu i zyrës së Këshillit të Sigurisë Kombëtare. Në punën e Këshillit të Sigurisë Kombëtare kryetari i parlamentit gjithashtu merr pjesë.

³⁷ *Po aty*, neni 104

³⁸ Poslovnik Hrvatskoga Sabora (Rregullorja e punës së Parlamentit të Republikës së Kroacisë) neni 63

³⁹ Ligji për Sistemin e Sigurisë dhe Inteligjencës, *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kroacisë* nr. 79/06

⁴⁰ *Po aty*, neni 3

përfshijnë burime të veçanta për mjediset e punës, pajisjet teknike, aftësi të posaçme në kryerjen e funksioneve të zbulimit dhe kundërzbulimit, edukimin, udhëzimin dhe trajnimin e punonjësve të agjencive të sigurisë dhe të zbulimit, si dhe për masat e fshehjes.⁴¹

Megjithatë, sipas ligjit të përmendur më lartë, të dhënat për buxhetet e agjencive të sigurisë-shërbimit të fshehtë nuk është publik. Duke parë në buxhetin vjetor të Republikës së Kroacisë, mund të vërehet se buxheti është shumë transparent kur ka të bëjë me institucione tjera shtetërore dhe tregon qëllimin deri në detaje; nga ana tjetër, kur vjen puna për AKIS, është publike vetëm shumica e përgjithshme që është ndarë në vit për punën e kësaj agjencie. Kjo do të thotë se publiku nuk ka informacione në lidhje me shpenzimet e detajuara të fondeve buxhetore, prandaj është shumë e rëndësishme mbikëqyrja nga institucionet e emëruara, duke përfshirë Parlamentin si përfaqësues i qytetarëve.

Publiku në Kroaci disa herë ka reaguar kundër mungesës së transparencës së buxheteve të agjencive të zbulimit dhe shumës së fondeve që janë të caktuar për ta. Mediet reagojnë për ndërtimin e ndërtesës së re të AKIS-s në verën e vitit 2012 duke thënë se buxheti i shtetit është i dëmtuar. Mediet patën sukses në heqjen klasifikimit të kostos së ndërtimit.⁴²

Miratimi i buxhetit

Komisioni për Politikë të Brendshme dhe Siguri Kombëtare është i përfshirë në mënyrë aktive në procesin e miratimit të buxhetit. Sipas nenit 140 nga Rregullorja e punës së Kuvendit, Komisioni e shqyrton propozimin-buxhetin sipas procedurës standarde për çfarëdo ligj. Duke analizuar uebfaqen e Parlamentit kroat, ka dëshmi se Komisioni për Politikë të Brendshme dhe Siguri Kombëtare ka rishikuar buxhetin vjetor për vitet e fundit në praninë e përfaqësuesve të autoriteteve të prekura (MPB, MM, Agjencia e Sigurimit dhe Zbulimit, Agjencia Ushtarake për Siguri dhe Zbulim, Qendra Operacionale dhe Teknike për Ndjekjen e Telekomunikacionit, Instituti për Siguri të Sistemeve Informativë, Drejtoria Shtetërore për Mbrojtje dhe Shpëtim).

Gjatë këtij hulumtimi, Komisionet kanë vënë me ligj të gjitha mjetet në dispozicion të tyre. Kjo do të thotë se ata mund të kërkojnë personel të autorizuar nga ministritë dhe agjencitë e tjera shtetërore për të marrë pjesë në seancat e tyre dhe të shpjegojë të gjitha çështjet me interes për Komisionet, të cilat në praktikë ata e bëjnë me mjaft padurim ... parlamenti mund të kontrollojë buxhetet e propozuara, t'i ndryshojë ato, t'i dërgojë përsëri për shqyrtim dhe të

⁴¹ Po aty, neni 115

⁴² Index, 2012, Darko Petričić: Ndërtimi i ndërtesës së re të AKIS shteti dëmtohet për 40 milion euro (Darko Petričić: Na izgradnji nove zgrade SOA-e država je oštećena za 40 milijuna eura) në dispozicion në: <http://www.index.hr/vijesti/clanak/darko-petricic-na-izgradnji-nove-zgrade-soae-drzava-je-ostecena-za-40-milijuna-eura/627440.aspx>

*vendosë për shumat nominale dhe strukturën e çdo buxheti në veçanti. Kjo ndodh rregullisht dhe nganjëherë rezulton në qindra amendamente në tekstin përfundimtar të buxhetit.*⁴³

Buxheti i agjencive të zbulimit, si pjesë e buxhetit vjetor miratohet në seancë plenare në Parlament.

Ekzekutimi i Buxhetit

Komisioni për Politikë të Brendshme dhe Siguri Kombëtare ka shumë mekanizma në dispozicion që mundësojnë mbikëqyrjen e zbatimit të buxhetit nga agjencitë e zbulimit, duke siguruar që paratë publike të shpenzohen në mënyrë të ligjshme dhe legjitime.

Megjithatë, rasti i Kroacisë është specifik dhe kjo ndryshon nga praktikat e tjera në rajon. Komisioni për Politikë të Brendshme dhe Siguri Kombëtare kryen mbikëqyrjen në mënyrë indirekte, kryesisht përmes Zyrës së Këshillit për Siguri Kombëtare (ZKSK). Komisioni mund të kërkojë ZKSK të japë raport ose informacion në lidhje me punën e shërbimeve ose ajo mund të kërkojë ZKSK të kryejë një hetim profesional të shërbimeve të sigurisë dhe zbulimit. Ligji për Sistemin e Sigurimit dhe të Zbulimit në mënyrë të qartë përcakton se, ndër të tjera, ZKSK mbikëqyr përdorimin e financave. Në këtë mënyrë, bëhet punë proaktive nga Komisioni parlamentar dhe inspektimet mund të bëhen kur deputetët e konsiderojnë të nevojshme. Për më tepër, është e siguruar që inspektimi të kryhet nga një organ profesional, i cili tejkalon çështjen e mungesës së ekspertizës në mesin e parlamentarëve.

Nëse ZKSK gjen shkelje të dispozitave ligjore, kreu i ZKSK duhet të ndërmarrë masa që menjëherë t'i heqë parregullsitë e zbuluara, dhe pas kësaj të informojë Presidentin, Kryeministrin dhe Kryetaren e Parlamentit në rastet kur inspektimi është kryer me kërkesë të Komisioni për Politikë të Brendshme dhe Siguri Kombëtare.⁴⁴ Masat e tilla përcaktohen sipas rregulloreve të Qeverisë, me pëlqimin paraprak nga Presidenti i Republikës.

Të pasurit e një mbikëqyrjeje ekspertësh është një forcë e rëndësishme që mund të zbutë mungesën e kapaciteteve në mesin e deputetëve të cilët nuk mund të pritët që të bëhen ekspertë në çështjet financiare, mbrojtjes së të dhënave ose të mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Më tepër, ZKSK ofron mbështetje ekspertize dhe administrative për Këshillin e Sigurimit Kombëtar dhe Këshillit për Koordinimin e Sigurisë dhe shërbimeve të Zbulimit; kjo do të thotë se punonjësit e ZKSK mund të ketë komunikim shumë më të lehtë dhe më të rrjedhshëm me shërbimet. Ata posedojnë një histori të aktiviteteve të këtyre shërbimeve dhe kanë një pasqyrë më të mirë sa i përket "çfarë të kërkojnë" kur kryhet mbikëqyrja. Duke pasur një trup të veçantë që kryen mbikëqyrje do të thotë se komunikimi në mes të atij trupit dhe komisionit parlamentar të

⁴³ Dr. Sandro Knezovich dhe Zvonimir Mahechic, *Kapitulli 3 - Kroacia*, në *Almanah për mbikëqyrjen mbi sektorin e sigurisë në Ballkanin Perëndimor*, Beograd 2012, në dispozicion: http://analyticamk.org/images/stories/files/almanac_mac.pdf

⁴⁴ Ligji për Sistemin e Sigurisë dhe Inteligjencës [Law for security-intelligence system] Neni 109

ngarkuar për kryerjen e mbikëqyrjes është e rëndësishme. Megjithatë, ka një mungesë të komunikimit të rregullt ndërmjet ZKSK dhe Komisionit për Politikë të Brendshme dhe Siguri Kombëtare. ZKSK nuk i dorëzon rregullisht raportet e veta për mbikëqyrjen e kryer, por vetëm pasi t'i kërkojë Komisioni. Më tepër, ZKSK nuk është organ i pavarur, por vepron në emër të Presidentit dhe Kryeministrit, kreu i ZKSK emërohet me vendim të përbashkët të Presidentit dhe Kryeministrit.

Në rastet kur Komisioni dëshiron të kontrollojë punën e agjencive të zbulimit dhe nuk dëshiron të besojë atë përmes ZKSK, mund të vendosë të ushtrojë kontroll të drejtpërdrejtë mbi punën e tyre. Në këtë rast, rregullat ligjore për ZKSK zbatohen nga Komisioni. Kjo do të thotë se raportet dhe dokumentet e tjera që i përkasin shërbimeve të zbulimit janë të arritshme për të, dhe ka mundësi për të folur me kreun e shërbimit dhe me të punësuarit në shërbime. Kjo vihet në dispozicion në bazë të një kërkesë të detajuar.⁴⁵ Ashtu si në rastin e Sllovenisë, Komisioni parlamentar kroat gjithashtu ka mundësi t'i thërrasë punonjësit e shërbimeve të zbulimit për të qenë të pranishëm në takimet e Komisionit dhe tu përgjigjen pyetjeve të caktuara. Megjithatë, kjo mundësi nuk funksionon në praktikë. Sipas përfaqësuesit nga Komisioni për Politikë të Brendshme dhe të Sigurisë Kombëtare, të intervistuar për qëllimet e këtij studimi, Komisioni observohet në mënyrë të vazhdueshme nga mediet, kështu që identiteti i punonjësit nuk do të mbetet i mbrojtur

Në qoftë se buxheti duhet të ribalansohet gjatë vitit, Komisioni do të diskutojë propozimin në një takim të Komisionit.

Auditimi i Buxhetit

Auditimi i jashtëm shtetëror në Republikën e Kroacisë kryhet nga EShR (Enti Shtetëror për Revizion) i cili është një institucion i pavarur autonom i cili përgjigjet para Kuvendit. EShR planifikon dhe zbaton auditimin në përputhje me programin vjetor dhe planin e punës, por edhe me kërkesë të Parlamentit kroat, nëse Revizori i Përgjithshëm vendos që kërkesa është e justifikuar.⁴⁶ Për punën e vet dhe të revidimet e kryera, EShR paraqet një raport një herë në vit në Kuvend, dhe më pas raportet publikohen në ueb faqen e tyre. Principi i funksionimit të organit suprem të auditimit është me sa duket shumë i ngjashëm me atë të EShR të Republikës së Maqedonisë. Në Rregulloren e punës së Kuvendit të Republikës së Kroacisë, ku të gjitha Komisionet që punojnë në suaza të Parlamentit caktohen së bashku me kompetencat e tyre, thuhet qartë se ky Komision për Politikë të Brendshme dhe Siguri Kombëtare i rishikon raportet e auditimit shtetëror dhe të policisë kriminale në lidhje me pjesët e lidhura me parregullsitë në punën financiare (neni 63). Komisioni rishikon raportet e Auditimit Shtetëror në praninë e

⁴⁵ *Po aty*, neni 107

⁴⁶ Ligji mbi Zyrën Shtetërore të Auditimit, neni 12

përfaqësuesve të EShR.⁴⁷ Megjithatë, për shkak të klasifikimit të informacioneve, nuk ka asnjë informacion publik në dispozicion të revidimeve që janë bërë deri më tani ose se si ato kanë ndikuar punën e komisionit parlamentar në lidhje me mbikëqyrjen e ciklit buxhetor të agjencive të zbulimit.

Kapacitetet administrative dhe menaxhuese

Komisioni për Politikë të Brendshme dhe Siguri Kombëtare ka kryetar, nënkryetar dhe njëmbëdhjetë anëtarë. Kryetari gjithmonë vjen nga opozita, por partia në pushtet (apo koalicioni) ka shumicën e anëtarëve. Megjithatë, ky Komision nuk ka mbështetje dhe ekspertizë për çështje të veçanta në fushën e sigurisë kombëtare, dhe sidomos në lidhje me financimin e tyre.⁴⁸ Si mbështetje profesionale, Komisioni ka një sekretar, një këshilltar dhe një sekretar tjetër të përbashkët me një tjetër Komision.

Parlamenti i Kroacisë zakonisht përfshin ekspertë të jashtëm në punën e komisioneve parlamentare dhe ka një buxhet të veçantë për këtë qëllim. Në këtë mënyrë ai mundëson pjesëmarrje më të gjerë të shoqërisë civile në punën e parlamentarëve, që mund të kontribuojë në rritjen e cilësisë së diskutimeve. Megjithatë, Komisioni për Politikë të Brendshme dhe Siguri Kombëtare nuk përfshin praktika të tilla, sepse konsideron se Këshilli për mbikëqyrjen civile mbi shërbimet e sigurisë dhe zbulimit luan atë rol.⁴⁹ Këshilli për mbikëqyrje civile është i përbërë nga gjashtë anëtarë plus një kryetar, i zgjedhur përmes një thirrje publike të shpallur nga Këshilli për Politikë të Brendshme dhe Siguri Kombëtare. Anëtarët e Këshillit duhet të kenë diploma universitare dhe të paktën një anëtar duhet të ketë diplomë nga juridiku, një nga shkencat politike dhe një nga elektro-teknika. Anëtarët që kryejnë këtë funksion janë ekspertë të shquar dhe të njohur në Kroaci. Megjithatë, ky organ nuk ka autoritet në lidhje me financat e agjencive të zbulimit. Nga njëra anë, mund të konkludohet se mbështetja e duhur profesionale për Komisionin nga aspekti financiar nuk jepet direkt. Nga ana tjetër, agjencitë e zbulimit në Kroaci mbikëqyren profesionalisht nga ZKSK dhe Komisioni mund të kërkojë nga ky organ të kryejë një inspektim profesional që tregon përpjekjet për të tejkaluar mungesën e "si-të" në mesin e deputetëve.

⁴⁷ Të dhënat janë marrë në bazë të raporteve të Komisionit për Politikë të Brendshme dhe të Sigurisë Kombëtare të publikuara në faqen e internetit të Parlamentit kroat.

⁴⁸ Intervistë me një përfaqësues të Komisionit për Politikë të Brendshme dhe Siguri Kombëtare

⁴⁹ *Po aty*

Përvoja pozitive nga vendet tjera në rajon

Mali i Zi

Në Mal të Zi, organ i autorizuar parlamentar për mbikëqyrje mbi agjencitë e sigurisë-shërbimit të inteligjencës është Komisioni për Mbrojtje dhe Siguri. Në dhjetor 2010 është miratuar ligji për mbikëqyrjen parlamentare, i cili përcakton mekanizmat që janë në dispozicion të Komisionit të bëjë mbikëqyrjen. Ky ligj gjithashtu përcakton marrëdhëniet në mes të Komisionit dhe institucioneve që i nënshtrohen mbikëqyrjes (Agjencia për Sigurinë Kombëtare, Ministria e Brendshme, Administrata e Policisë, Ministria e Mbrojtjes dhe organet dhe institucionet e tjera që kryejnë detyra relevante për sigurinë).

Ligji për Mbikëqyrjen Parlamentare të Sektorit të Sigurisë dhe të Mbrojtjes paraqet bazën ligjore për tre mekanizmat thelbësor: seanca konsultative, seanca kontrollues dhe hetim parlamentar.

- Seanca konsultative i referohet të ftuarit e përfaqësuesve të institucioneve shtetërore, organizatave joqeveritare dhe ekspertëve para miratimit të akteve ligjore apo përzgjedhjes së kandidatëve. Ligji lejon angazhimin e ekspertëve të jashtëm si konsulentë që paguhen nga Parlamenti. Në kohë kur një nga dobësitë më të mëdha të komisioneve parlamentare është mungesa e ekspertizës, të ftuarit ekspertë të jashtëm është një mjet shumë i dobishëm që ndihmon deputetët në mënyrë më të mirë ta kryejnë mbikëqyrjen. Edhe kur nuk ka buxhet të veçantë për këtë qëllim, duke mbledhur të gjitha palët e interesuara në një vend ku ata mund të diskutojnë temë të veçantë, mund të jetë shumë e dobishme për anëtarët e komisionit.
- Seancat kontrolluese kryhen në raste të çështjeve të diskutueshme dhe ku ka një nevojë për shpjegime dhe sqarime të mëtejshme lidhur me veprimet apo politikat e caktuara. Komisioni vendos të zhvillojë një seancë kontrolluese me anë të një shumice votash. Në praktikë, Komisioni zhvillon një seancë dëgjimore të kontrollit një herë ose dy herë në vit, ku ajo miraton konkluzione dhe rekomandon masat që duhet të ndërmerren.
- Seancat konsultative ose kontrolluese mund të rezultojnë në një vendim që të fillojë një hetim parlamentar kur ka një nevojë për të mbledhur informacion të mëtejshëm apo ku ka një bazë për të pasur parasysh përgjegjësinë e zyrtarëve publikë..

Mes kompetencave tjera⁵⁰, Ligji për Mbikëqyrje Parlamentare qartë thotë se ky Komision ka kompetencë për të shqyrtuar informacion në lidhje me buxhetin e sigurisë dhe shërbimeve të zbulimit të përfshirë në diskutimin e propozim-buxhetit, zbatimin e buxhetit dhe raportet e

⁵⁰ Kompetencat janë të shënuara në nenin 7 të Ligjit për Mbikëqyrjen Parlamentare

auditimit nga ana Revizorit të Shtetit. Përveç kësaj, Komisioni jep sugjerime dhe propozime gjatë përgatitjes së buxhetit të shtetit, në lidhje me seksionet dedikuar për institucionet e sigurisë dhe zbulimit. Në praktikë, Komisioni i shfrytëzon ato kompetenca dhe në mbledhjet kanë marrë pjesë përfaqësues të institucioneve që i nënshtrohen mbikëqyrjes, si dhe përfaqësues të Ministrisë së Financave (kur diskutohet propozim-buxheti) dhe Institucioni i Revizorit Shtetëror (kur diskutohen raportet e auditimit dhe llogarisë përfundimtare për vitin e kaluar). Komisioni jep sugjerime dhe mendime për ato dokumente, por sugjerohet se paraqitja e amendamenteve në projekt-buxhet do të jetë një alternativë më e mirë për të ndikuar me burimet e dhëna për institucionin.⁵¹ Ky shembull mund të shërbejë si një mësim i rëndësishëm për parlamentet e tjera në rajon.

Përveç kësaj, Komisioni ka demonstruar një qasje proaktive në vitin 2011, kur ka kërkuar nga institucionet nën hetim raporte të hollësishme analitike për efikasitetin dhe efektivitetin e shpenzimeve të fondeve të shpërndara buxhetore. Agjencia Kombëtare e Sigurimit ka dorëzuar një raport të tillë në vitin 2012 në lidhje me vitin e kaluar (2011), por pa një nivel të kënaqshëm të kualitetit.⁵² E njëjta gjë vlen edhe për MPB. Vetëm MM-ja u përgjigj me shpjegime të hollësishme. Mund të konkludohet, pra, se mbikëqyrja është një rrugë me dy kahje dhe nuk varet vetëm nga qasja e Komisionit, por edhe në përgjigjet nga institucionet që janë subjekt i mbikëqyrjes.

Ligji për Mbikëqyrjen Parlamentare është miratuar së shpejti dhe prandaj është një faktor kufizues për të bërë çdo lloj të konkluzioneve në lidhje me praktikën e mbikëqyrjes financiare të shërbimeve të zbulimit në Mal të Zi, si dhe për ndikimin që prurja e këtij ligji të veçantë mund të ketë në punën e organeve parlamentare. Megjithatë, përvoja e deritanishme tregon se ligji i ri ka shërbyer si katalizator për inkurajimin e një qasje më pro-aktive të deputetëve. Rritja e mbikëqyrjes së buxhetit shkon dorë për dorë me zhvillimin e trajnimeve për mbikëqyrjen buxhetore për shërbimin profesional të Komisionit. Është e rëndësishme të theksohet se Komisioni përgatit një plan vjetor për mbikëqyrjen parlamentare i cila shërben si udhërrëfyes për aktivitetet e tij gjatë gjithë vitit.

Si garanci për zbatimin e Ligjit për Mbikëqyrjen Parlamentare të Sektorit të Sigurisë dhe Mbrojtjes, hartuesit e politikave kanë përfshirë dispozitat penale për institucionet dhe punonjësit e tyre në rastet kur ata nuk marrin pjesë në mbledhjet e komisioneve, nuk paraqesin informacionin e kërkuar ose nuk lejojnë mbikëqyrje parlamentare.

⁵¹ Institute Alternativa *Ligji mbi mbikëqyrjen parlamentare në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes - Viti i dytë i zbatimit*, në dispozicion: <http://media.institut-alternativa.org/2013/03/zakon-o-parlamentarnom-nadzoru-u-oblasti-bezbednosti-i-odbrane.pdf>

⁵² Sipas raportit të monitorimit nga ana e Institutit Alternativa, raportet nga Agjencia Kombëtare e Sigurimit dhe MPB-së "nuk shkojnë përtej modeleve formale dhe pasqyrave tipike të rrjedhës së parasë".

Kosova

Sektori i sigurisë dhe inteligjencës në Kosovë është themeluar së shpejti, së këndejmi edhe praktika e mbikëqyrjes parlamentare. Si e tillë, është e vështirë për të hartuar konkluzione për çfarëdo praktike të mirë apo të keqe. Megjithatë, duket se Kuvendi i Kosovës thekson rëndësinë e funksionit të mbikëqyrjes dhe për këtë arsye ka hartuar një Doracak për Funksionimin e Mbikëqyrjes nga ana e Parlamentit.⁵³ Ky doracak është një udhëzues universal i zbatueshëm për të gjitha organet parlamentare dhe përmban udhëzime për planifikimin e aktiviteteve të mbikëqyrjes, përfshirjen e shoqërisë civile në aktivitetet mbikëqyrëse, mbikëqyrjen mbi zbatimin e ligjeve dhe gjithashtu marrëdhëniet me institucionet e pavarura që kryejnë mbikëqyrje. Ky Doracak përmban një kapitull të veçantë për mbikëqyrjen buxhetore të institucioneve nacionale.

Përveç kësaj, ka një Doracak për Ekspertiza të Jashtme në Komisionet Parlamentare.⁵⁴ Doracaku e detajon rolin e ekspertëve të jashtëm në punën parlamentare, procedurën për të angazhuar ekspertë individualë dhe benefitet nga ekspertiza e ofruar nga organizatat “think tank” dhe organizatat joqeveritare. Ai gjithashtu përmban të gjitha format dhe dokumentet e standardizuara që janë të nevojshme për bashkëpunim. Secili komision ka buxhetin e vet që mund të përdoret për të angazhuar ekspertizë të jashtme, organizimin e dëgjimeve mbikëqyrëse dhe kështu me radhë.

Faqja e internetit e Kuvendit të Kosovës ka një hapësirë në të cilën CSO-të që janë të interesuar në punën e Kuvendit mund të regjistrohen dhe të ofrojnë informacione në lidhje me punën dhe fushat e ekspertizës së tyre. Organizatat duhet të lënë informatat e kontaktit dhe të theksojnë se për cilat aspekte të punës së Kuvendit ose të komisioneve parlamentare ata janë të interesuar. Kjo informatë është në dispozicion për të gjithë deputetët dhe të punësuarit në Parlament në mënyrë që ata të mund të identifikojnë pjesëmarrësit potencialë dhe ekspertët për dëgjimet publike, konsultimet, vizitat studimore dhe aktivitetet tjera. Kjo është një mundësi e shkëlqyer për ata deputetë që kanë njohuri të kufizuara për një fushë të caktuar, pasi ata me lehtësi mund të gjejnë organizata që kanë ekspertizë në fushë.

Megjithatë, këto janë mekanizma të reja dhe përdorimi i tyre ose ndikimi në punën e komisioneve parlamentare ende nuk është vlerësuar. Sidoqoftë, është një shenjë pozitive që është

⁵³ Ky manual është në dispozicion në gjuhën angleze në linkun e mëposhtëm:

<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/SOM%20Funksioni%20mbikqyres%20i%20komisioneve%20parlamentare-Eng.pdf>

Manuali është në dispozicion edhe në gjuhën shqipe:

[http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/SOM_Funksioni%20mbikqyres%20i%20komisioneve%20parlamentare-Alb%20\(2\).pdf](http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/SOM_Funksioni%20mbikqyres%20i%20komisioneve%20parlamentare-Alb%20(2).pdf)

⁵⁴ Ky manual është në dispozicion në gjuhën angleze në linkun e mëposhtëm::

<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Doracak%20-%20Ekspertiza%20e%20Jashtme%20-%20ENG.pdf>

Manuali është në dispozicion edhe në gjuhën shqipe: <http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Doracak%20-%20Ekspertiza%20e%20Jashtme%20-%20ALB.pdf>

theksuar funksioni i mbikëqyrjes i Parlamentit dhe se ka vend për bashkëpunim me shoqërinë civile.

Konkluzioni

Ky dokument kishte për qëllim të identifikojë praktikat më të mira në kryerjen e mbikëqyrjes financiare parlamentare të agjencive të inteligjencës si dhe evidentimin e sfidave të përbashkëta. Rastet studimore të përfshira në këtë hulumtim treguan se nuk ekziston vetëm një model i "praktikës së mirë" në këtë zonë të caktuar, por që çdo vend ka zhvilluar dizajnin e vet sipas nevojave të tyre specifike, derisa ecën drejt përgjegjësisë dhe transparencës më të mirë.

Derisa Sllovenia ka një komision parlamentar të dedikuar ekskluzivisht për mbikëqyrjen e shërbimeve të inteligjencës, duke mbuluar çdo aspekt të punës së shërbimeve të inteligjencës, Kroacia ka zhvilluar një model më të ndërlikuar që përfshin organin parlamentar, ekspert dhe organet civile që ndërthurin dhe plotësojnë njëri-tjetrin. Ata kanë një komision parlamentar për Politikën e Brendshme dhe të Sigurisë Kombëtare që është e specializuar jo vetëm në mbikëqyrjen, por është edhe Komisioni amë i të gjitha çështjeve që lidhen me sigurinë dhe punëve e brendshme. Maqedonia ka projektuar edhe mekanizmin e vet që ndan përgjegjësitë në mes tre komisioneve të ndryshme parlamentare, ku njëra trajton sigurinë dhe politikën e mbrojtjes dhe të tjerët janë të preokupuara me mbikëqyrjen e shërbimit të inteligjencës.

Kur bëhet fjalë për kornizën ligjore, modele të ndryshme kanë qenë gjithashtu të zhvilluara – me ekzistencën e një ligji të veçantë për mbikëqyrjen e inteligjencës/sigurisë (në Slloveni dhe Mal të Zi), një ligj i vetëm që rregullon sistemin e sigurisë dhe të inteligjencës si një e tërë, duke përcaktuar të gjitha palët, përfshirë dhe rolin e Parlamentit (në Kroaci), ose dispozita të shpërndara në disa ligje të ndryshme (në Maqedoni). Megjithatë, ajo që ka më shumë rëndësi është që dispozitat ligjore të përcaktohen mirë dhe të definohen të cilat do të ofronin një mandat të qartë për komisionet parlamentare dhe përcaktonin mekanizma që mund të përdoren nga deputetët në kryerjen e aktiviteteve të tyre të mbikëqyrjes.

Duke marrë parasysh aktivitetet gjatë ciklit buxhetor, përvojat nga rajoni tregojnë se përfshirja e komisioneve parlamentare në fazën e planifikimit është ende shumë e kufizuar. Por komisionet kanë ndikim në fazën e miratimit nëpërmjet ndërhyrjeve për ndryshime. Praktikën e mira përfshijnë diskutimin e projekt-buxhetin në takime të komisionit, në prani të përfaqësuesve nga agjencitë e inteligjencës dhe/ose të Ministrisë së Financave. Në këtë mënyrë deputetët do të mund të kuptojnë më mirë nevojat e agjencive të zbulimit dhe të marrin burime financiare shtesë kur është e nevojshme, në dritën e faktit se ata janë pjesë e pushtetit legjislativ që në fakt miraton buxhetin kombëtar.

Sa për kompetencat, deputetët e Maqedonisë kanë pak a shumë të njëjtat mekanizma si kolegët e tyre nga rajoni - qasje të pakufizuar në informacione pavarësisht nga niveli i klasifikimit (në përgjithësi, ekzistojnë përjashtime në rastet që kanë të bëjnë me mision të vazhdueshme ose kur ekziston rreziku për burimet njerëzore të agjencive të ekspozohen, e cila përputhet plotësisht me standardet ndërkombëtare). Për më tepër, ata janë në gjendje të kryejnë vizita në terren, si dhe të diskutojnë raportet e agjencive në prani të përfaqësuesve të shërbimeve. Megjithatë, ato aftësi kanë nevojë për rregullime të mëtejshme në rastin e Maqedonisë në mënyrë për të parandaluar keqkuptimet. Për shembull, duket të ketë mungesë të konsensusit lidhur me atë nëse komisionet kanë të drejtë për të kryer vizita të paparalajmëruara dhe çfarë duhet të jetë përbërja e grupit vizitues, në lidhje me shkallën mes deputetëve që vijnë nga parti të ndryshme. Një tjetër mekanizëm i rëndësishëm është aftësia për të mbajtur konsultime publike dhe debate mbikëqyrëse. Megjithatë, në rastin e Maqedonisë, ky mekanizëm nuk është unik për komisionet e inteligjencës dhe sigurisë, por është në dispozicion për çdo komision parlamentar dhe është e rregulluar me Rregulloren e Punës të Parlamentit. Përvoja e Malit të Zi ka treguar se futja dhe akomodimi i këtyre aftësive në dispozitat ligjore që rregullojnë punën e organeve të mbikëqyrjes mund të ketë një ndikim pozitiv në drejtim të rritjes së motivimit për përdorimin e tyre.

Për më tepër, komisionet parlamentare konsiderojnë raportet vjetore nga agjencitë që përfshijnë informacion në lidhje me performancën e tyre financiare. Këto raporte janë një mjet i rëndësishëm për vlerësimin e punës së agjencive dhe mund të shërbejnë më tej si një bazë e mirë për të diskutuar mësimet e nxjerra dhe nevojat e ardhshme. Komisionet e Maqedonisë duhet të zhvillojnë komunikim më të mirë me ISA dhe të diskutojnë raportet e auditimit kur auditimet e tilla janë kryer në agjencitë e inteligjencës.

Një e metë e madhe për të gjitha komisionet parlamentare është mungesa e kapaciteteve administrative dhe "know-how"(dije-si) të merren me çështje të veçanta financiare. Ata të gjithë e kanë identifikuar nevojën për mbështetje dhe ekspertizë shtesë. Politizimi është e njohur si një tjetër sfidë e përbashkët dhe Kroacia është një vend që është më e avancuara kur bëhet fjalë për vendosjen e mekanizmave të veçanta për shmangien e çrregullimit të punës së komisionit për shkak të interesave partiake të deputetëve.

Krahas mbikëqyrjes dhe kontrollit të jashtëm, mekanizmat e brendshme të kontrollit dhe menaxhimit të shërbimeve luajnë një rol të rëndësishëm. Është e nevojshme që të sajohen rregulla të rrepta të brendshme dhe kontroll të vazhdueshëm mbi incidentet ku politika "zero tolerancë" do të aplikohet dhe abuzimet do të parandalohen, hetohen dhe dënohen.

Rekomandime

- Korniza ligjore duhet të zhvillohet më tej në mënyrë që të rregullohet mandati i komisioneve parlamentare dhe të definohen mekanizmat në dispozicion të tyre në mënyrë të qartë dhe të saktë. Duke përfshirë vendosjen e marrëdhënieve me shërbimet, që më tej rregullon vizitat në terren në shërbimet e inteligjencës (a duhen ato të paralajmërohen ose pa paralajmërim? Përbërja e grupeve të punës dhe kështu me radhë) dhe futjen e debateve mbikëqyrëse. Përveç kësaj, mundësia për të pyetur për raportet e veçanta apo informacione gjatë gjithë vitit duhet të rregullohet, duke vendosur procedura për kërkimin e informacioneve shtesë dhe afatet për shërbimet të ofrojnë atë që iu është kërkuar. Derisa disa nga këto rregullore kërkojnë ndryshime në legjislacionin primar, shumë prej tyre do të mund të futen thjesht në Rregulloren e Punës së Komisioneve.
- Siç tregoi hulumtimi, ekziston një mungesë e komunikimit midis komisioneve dhe agjencive të Maqedonisë që janë subjekt i mbikëqyrjes në krahasim me vendet e tjera të rajonit. Mund të jetë e dobishme për deputetët që të ndjekin shembullin slloven, duke formuar këtë organ parlamentar për herë të parë në një mandat të ri dhe të bëjnë një vizitë nëpër agjencitë. Në këtë mënyrë do të "thyhet akulli" dhe deputetët do të njoftohen me punën e agjencive.
- Komisionet duhet të kenë një rol në çdo fazë të ciklit të buxhetit (planifikim, miratimit, zbatimit dhe rishikimit). Ata duhet të diskutojnë propozimin për buxhetin vjetor si kategori e posaçme të rendit të ditës në prani të përfaqësuesve nga agjencitë dhe/ose Ministrisë së Financave si propozues-buxhetor. Anëtarët e komisioneve të gëzojnë qasje në të gjitha të dhënat dhe dokumentet e nevojshme për mbikëqyrje efektive dhe si e tillë, buxhetet duhet të jenë gjithëpërfshirës dhe të përfshijnë të gjitha aspektet e punës së shërbimeve të inteligjencës.
- Komisionet duhet të forcojnë marrëdhëniet e tyre me ISA. Të punësuarit në institucionin suprem të auditimit (ISA) janë profesionistë në fushën e financave dhe, për rrjedhojë, mund të sigurojnë analiza të detajuara mbi shpenzimet. Për më tepër, procesi i auditimit duhet të përsëritet në mënyrë të rregullt brenda një periudhe të caktuar kohore. Institucioni suprem i auditimit ka njohuritë e nevojshme, aftësitë dhe përvojën për kontroll financiar dhe, në të njëjtën kohë, ajo mbron fshehtësinë e informacionit të klasifikuar. Komisionet parlamentare duhet të rishikojnë raportet e auditimit të kryera dhe të përkrahin zbatimin e rekomandimeve të tyre
- Kur propozohen anëtarët e komisioneve për mbikëqyrjen, partitë politike duhet të jenë të vetëdijshme për afinitetet e tyre personale, dhe të marrin parasysh njohuritë e tyre, përvojën dhe aftësitë për kryerjen e detyrave. Vullneti politik, vullneti i individit dhe

aftësia janë faktorë të rëndësishëm që ndikojnë në performancën e mbikëqyrjes adekuate. Për më tepër, ka nevojë për procedura strikte për rregullimin e rasteve kur anëtarët e Komisionit mund të zëvendësohen. Përbërja e komisioneve për mbikëqyrje nuk duhet të ndryshohet nga partitë politike pa ndonjë shpjegim të arsyeshëm dhe me procedurë të posaçme.

- Pasiqë komisionet kanë burime të pamjaftueshme njerëzore dhe teknike për të mundësuar mbikëqyrje të drejtë financiare, ata duhen të kenë qasje në ekspertizë të jashtme në mënyrë që të kuptojnë aspektet specifike të punës financiare. Në rastet kur nuk është e mundur, për shkak të burimeve të kufizuara financiare, komisionet duhet të shqyrtojnë mbajtjen e dëgjimeve publike, ku ata do të ftojnë ekspertë, përfaqësues të OShC-ve dhe akademik. Përveç kësaj, përfaqësues nga Ministria e Financave dhe ISA do të mund të kontribuonin gjithashtu me ekspertizën e tyre.

Bibliografia

Republika e Maqedonisë:

Ligji i Agjencisë së Kundërzbulimit [Law on Intelligence Agency] *Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë* Nr.92/2009

Ligji i Punëve të Brendshme [Law on Internal Affairs] *Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë* Nr. 92/2009

Rregullat e Punës të Parlamentit të Republikës së Maqedonisë – tekst i konsoliduar *Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë* Nr. 130/2010

Ligji i Parlamentit të Republikës së Maqedonisë [Law on the Parliament of the Republic of Macedonia] *Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë* Nr.104/09

Raporti vjetor i Zyrës Shtetërore të Auditimit për vitin 2007, në dispozicion:

<http://www.dzr.mk/Uploads/MIJALCO%20-%20Godisen%20izvestaj%20za%20WEB%20-%20FINALE.pdf>

Raporti final i Auditorit Shtetëror të autorizuar, n. 1003-656/6, në dispozicion:
<http://www.dzr.mk/Uploads/2006%20-%20Agen%20za%20razuznavanje-Budzet.pdf>

Republika e Sllovenisë:

Ligji i Procedurës Penale, *Gazeta Zyrtare e Republikës së Sllovenisë* 8/2006:

Ligji i Agjencisë Sllovene të Inteligjencës dhe Sigurisë - verzion i konsoliduar (ZSOVA-UPV2) *R.S. Gazeta Zyrtare* Nr.81/06

Ligji mbi Kontrollin Parlamentar të shërbimeve të inteligjencës dhe sigurisë *Gazeta Zyrtare e Republikës së Sllovenisë* Nr. 26/03 – ZPNOVS

Rregullorja e Punës së Komisionit për Mbikëqyrjen e Shërbimeve të Inteligjencës dhe Sigurisë [Rules of Procedure of the Committee for Oversight over the Security-Intelligence Agencies]

Ligji i Gjykatës së Auditimit [Audit Court Act] *Gazeta Zyrtare e R.S.* Nr. 11/01

Uebfaqja e Parlamentit të Republikës së Sllovenisë (Državni Zbor) <http://www.dz-rs.si>

Uebfaqja e ASIS Agjencia Sllovene e Inteligjencës dhe Sigurisë <http://www.сова.gov.si>

Republika e Kroacisë:

Ligji për Sitemin e Sigurisë dhe Inteligjencës [Law on the Security-Intelligence System] *Gazeta Zyrtare e Republikës së Kroacisë* nr.79/06

Rregullorja e punës së Parlamentit të Republikës së Kroacisë [Rules of Procedure of the Parliament of Croatia] verzion i konsoliduar, (NN Nr. 71/00, 129/00, 117/01, 6/02. – teksti i rishikuar, 41/02, 91/03, 58/04, 39/08, 86/08. dhe 81/12)

Uebfaqja e Parlamentit të Republikës së Kroacisë (Hrvatski Sabor): www.sabor.hr

Uebfaqja e AKIS, Agjencia Kroate e Inteligjencës dhe Sigurisë: www.soa.hr

Të tjera:

Andreja Bogdanovski dhe Magdalena Lembovska - *Drejt brezit të dytë (2) të sektorit të sigurisë në reformat në Maqedoni*, Shkup 2012, në dispozicion në:

<http://analyticamk.org/images/stories/books/pub-ssr-web.pdf>

Instituti Alternativa *Ligji mbi mbikëqyrjen parlamentare në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes - Viti i parë i zbatimit. Raporti i Monitorimit të Vitit 2011* Podgoricë, 2011. në dispozicion në:

<http://media.institut-alternativa.org/2012/07/institut-alternativa-zakon-o-parlamentarnom-nadzoru-u-oblasti-bezbjednosti-i-odbrane-prva-godina-primjene-mne.pdf>

Institute Alternativa *Ligji mbi mbikëqyrjen parlamentare në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes - Viti i parë i zbatimit. Raporti i Monitorimit të Vitit 2012* Podgoricë, 2013. në dispozicion në:

<http://institut-alternativa.org/zakon-o-parlamentarnom-nadzoru-u-oblasti-bezbjednosti-i-odbrane-druga-godina-primjene/>

Almanah për mbikëqyrjen mbi sektorin e sigurisë në Ballkanin Perëndimor, Beograd 2012, në dispozicion:

http://analyticamk.org/images/stories/files/almanac_mac.pdf

Hans Born dhe Aidan Wills (redaktorë) *Mbikëqyrja e Shërbimeve të Inteligjencës (Overseeing Intelligence Services – A Toolkit)*, DCAF Gjenevë, 2012

Doracaku i Parlamentit të Kosovës: *Kunksioni mbikëqyrës i Komisioneve Parlamentare Oversight*, në dispozicion:

<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/SOM%20Funkcioni%20mbikqyres%20i%20komisioneve%20parlamentare-Eng.pdf>

Doracak i Parlamentit të Kosovës: *Ekspertizat e Jashtme në Komisionet Parlamentare*, në dispozicion:

<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Doracak%20-%20Ekspertiza%20e%20Jashtme%20-%20ENG.pdf>

Rajko Radevic *Qeverisja Inteligjente në Mal të Zi*, DCAF, 2012, në dispozicion:

http://www.dcaf.ch/content/download/104946/1617883/version/2/file/montenegro_eng1.pdf

Intervista:

Intervistë me Mate Dragutin, Anëtar i Komisionit parlamentar për Mbikëqyrjen e Agjencive të Inteligjencës dhe Sigurisë, Slloveni zhvilluar më 04.12.2012

Intervistë me Andrej Rupnik, Ish-drejtor i Agjencisë Sllovene të Inteligjencës-Sigurisë ASIS zhvilluar më 11.12.2012

Intervistë me Prof. Dr. Miroslav Tudzman, Kryetar i Komisionit për Politika të Brendshme dhe Siguri Kombëtare, Kroaci zhvilluar më 14.02.2013



POLICY REPORT

Analizë krahasuese e praktikave rajonale për mbikëqyrjen parlamentare financiare të shërbimeve të inteligjencës

Magdalena Lembovska, *Hulumtuese në Programin për Politika të Jashtme dhe të Sigurisë*

mlembovska@analyticamk.org

Contact

Address:

Dame Gruev

No: 7-8/3

1000 Skopje, Macedonia

Tel:00389 (0)2 3121 948

Fax:00389 (0)2 3121 948

E-mail:info@analyticamk.org